



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI NR: 1

NR i VENDIMIT.: KPCC/D/A/203/2013
DATA E VENDIMIT: 11/06/2013

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

URDHËR

(1) Në secilën prej 12 (dymbëdhjetë) kërkesave të identifikuara në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur, Komisioni

vendos që

Paraqitësi i kërkesës ose mbajtësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, ka vërtetuar pronësinë për pronën e kërkuar, ose për atë pjesë të saj, ashtu si përcaktohet në vendimin individual përkatës;

(2) Në kërkesat nr. 14815, 50626 dhe 50630, të referua në pjesën C të listës së bashkangjitur, Komisioni

vendos që

Paraqitësi i kërkesës ose mbajtësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, ka vërtetuar të drejtën e shfrytëzimit për pronën e kërkuar, ose për atë pjesë të saj, ashtu si përcaktohet në vendimin individual përkatës;

(3) Në kërkesat nr. 25086, 25087, 25088, 25089, 25090, 25091 dhe 90041, të referuara në pjesën B të listës së bashkangjitur, Komisioni,

vendos që

Paraqitësi i kërkesës ka vërtetuar pronësinë e mbajtësit të ndjerë të së drejtës pronësore për pronën e kërkuar, ose për atë pjesë të saj, ashtu si përcaktohet në vendimin individual përkatës;

(4) Në secilën prej 22 (njëzetedy) kërkesave të referuara në paragrafin (1) dhe (2) më sipër, përveç kërkesave nr. 40674 dhe 40675, Komisioni

urdhëron që

(a) Paraqitësit të kërkesës apo bartësit e së drejtës pronësore, sipas rastit, t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar;

(b) Pala përgjegjëse ose çdo person i cili ka uzurpuar pronën në mënyrë të paligjshme, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri; dhe

(c) Nëse pala përgjegjëse ose çdo person që ka uzurpuar pronën në mënyrë të paligjshme, i cili dështon të përmbushë urdhrin për lirimin e pronës brenda kohës së dhënë, të dëbohet nga prona;

(5) Në secilën prej kërkesave të identifikuar në kolonat përkatëse në pjesët A, B dhe C të listës së bashkangjitur, Komisioni më tutje vendos që kërkesat të hidhen poshtë kur paraqitësit e kërkesave kërkojnë kompensim për dëmin material apo për humbjen e shfrytëzimit të pronës së kërkuar; dhe

(6) Në rastet kur ka më shumë se një pronar, vendimi dhe urdhrat e lartpërmendur nuk ndikojnë në të drejtat përkatëse të bashkëpronarëve.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin i themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("AKP") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi i kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedim të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

(a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose

(b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlikdhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposëdim në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

5. Komisioni mbajti seancën e tridhjetepetë nga 10 deri 11 qershor 2013 në Prishtinë. Komisionit i janë paraqitur gjithsej 495 kërkesa për pronë bujqësore në seancën e tridhjetepetë nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera relevante. Gjithsej 495 kërkesa për pronë bujqësore u vendosën nga Komisioni gjatë seancës.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave dhe çështjet ligjore dhe dëshmuar të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesa të përfshira në këtë vendim

7. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim, me përjashtim të kërkesave nr. 14815, 50626 dhe 50630, ku paraqitësit e kërkesave kërkojnë konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit për pronën e kërkuar, paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës pronësore dhe të gjitha kërkesat kanë të bëjnë me prona bujqësore, përfshirë arat, kullotat dhe pyjet.

8. Ky vendim zbatohet për 22 kërkesat të identifikuar në listën e bashkangjitur. Kërkesat nr. 16521, 16522, 16523 dhe 22016 kanë qenë subjekt i një vendimi² të mëparshëm të Komisionit. Megjithatë, vendimi i mëparshëm në këto kërkesa është shfuqizuar nga Komisioni për shkak të notifikimit të pasaktë të pronës së kërkuar gjatë përpunimit të kërkesës nga Sekretaria Ekzekutive ose për shkak të gabimeve të përpunimit nga Sekretaria Ekzekutive të cilat janë identifikuar pasi është marrë vendimi. Për rrjedhojë, këto kërkesa

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhërësën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Anekset e saj. Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Anekset e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Anekset e Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Anekset I, II dhe III, respektivisht.

² Kërkesa. 16521 është vendosur me vendim të Komisionit KPCC/D/2/2007 datë 3 shtator 2007, Kërkesat nr. 16522 dhe 22016 janë vendosur me vendim të Komisionit KPCC/D/A/5/2007 datë 19 dhjetor 2007 dhe Kërkesa nr. 16523 është vendosur me vendim të Komisionit KPCC/D/A/3/2007 datë 07 nëntor 2007.

duhet të rivendoset pas notifikimit të saktë të pronës së kërkuar dhe korrigjimit të gabimeve të përpunimit. Sekretaria Ekzekutive i ka shkruar paraqitësit të kërkesës duke e informuar ata për gabimet e notifikimit dhe i ka informuar se kërkesa do të rivendoset pas notifikimit të saktë të pronës të kërkuar. Paraqitësit e kërkesës si dhe autoritetet e kadastrave përkatëse janë informuar se vendimi i mëparshëm i Komisionit është pavlerë dhe nuk mund të përdoret për qëllimet e çfarëdo transaksioni ligjor. Pjesa e mbetur prej 473 kërkesave për pronë bujqësore të trajtuara nga Komisioni gjatë seancës përfshihen në dy vendimet e tjera pikërisht vendimin KPCC/D/A/202/2013 dhe vendimin KPCC/D/A/204/2013.

9. Të 22 kërkesat e përfshira në këtë vendim janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronat e kërkuara ose pala që ka shprehur interes ligjor në këto prona ("pala përgjegjëse") e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit 30 ditor të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedurës në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079.

10. Me qëllim që të përmbushen kushtet e një kërkesë të vlefshme, paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, duhet të tregojë se ai ka pasur të drejtë pronësore në lidhje me pronën e kërkuar dhe se ai ose ajo nuk ka mundësi të ushtrojë të drejtën pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë ose rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

1. Kërkesa kontestuese – mbrojtje e thjeshtë

11. Në dy kërkesat e identifikuar në pjesën A të listës së bashkangjitur, pala që ka uzurpuar pronën e kërkuar ose pala që ka shprehur interes ligjor në këtë pronë ("Pala përgjegjëse") ose nuk ka paraqitur mbrojtje të vlefshme në përgjigje të kërkesës ose thjesht ka kërkuar të ketë lejen e paraqitësit të kërkesës për të shfrytëzuar pronën pa ofruar ndonjë dëshmi në mbështetje të pretendimit. Në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga palët përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesat duhet të miratohen.

a. Kërkesa nr. 22016

12. Kërkesa nr. 22016 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore pikërisht, babait të tij të ndjerë. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore për pronën e kërkuar dhe riposedimin. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletën poseduese të vitit 2002, që e identifikon mbajtësin e së drejtës pronësore si pronar të pronës së kërkuar. Fleta poseduese është verifikuar si e vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive.

13. Pala përgjegjëse kërkon të drejta ligjore për pronën e kërkuar, megjithatë ajo dështoi të ofrojë dëshmi në mbështetje të këtij pohimi.

14. Bazuar në dëshmitë para tij dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet.

b. Kërkesa nr. 33486

15. Kërkesa nr. 33486 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e bashkëpronësisë për pronën e kërkuar dhe riposedimin. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një vendim për konsolidimin e tokës të vitit 1987, sipas të cilit prona e

kërkuar i ishte ndarë paraqitësit të kërkesës në bashkëpronësi. Vendimi është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si i vërtetë.

16. Pala përgjegjëse kërkon të drejta ligjore për pronën e kërkuar, megjithatë pala përgjegjëse dështoi të ofrojë dëshmi në mbështetje të këtij pohimi.

17. Bazuar në dëshmitë para tij dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet.

2. *Kërkesa kontestuese – të tjera*

18. Në njëzet kërkesat e identifikuar në pjesën B dhe C të listës së bashkangjitur, pala apo palët që kanë uzurpuar pronat e kërkuara, ose pala që ka shprehur interes ligjor në këto prona (“pala përgjegjëse”) e ka kundërshtuar vlefshmërinë e kërkesës, megjithatë Komisioni ka arritur në përfundimin se kërkesat duhet të miratohen për arsyet e përmendura më poshtë.

a. *Kërkesa nr. 08816*

19. Në kërkesën nr. 08816, paraqitësi i kërkesës kërkon në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore, konfirmimin e bashkëpronësisë dhe riposedimin. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme të vitit 2008 që e identifikon babain e paraqitësit të kërkesës si bashkëpronar të pronave të kërkuara. Më tej, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një vendim trashëgimie të vitit 2008, që tregon se paraqitësi i kërkesës ka trashëguar të drejtën e bashkëpronësisë nga babai i tij. Certifikata për të drejtat e pronës së paluajtshme dhe vendimi i trashëgimisë janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si të vërteta.

20. Pala përgjegjëse kërkon të drejta ligjore për pronën e kërkuar duke pretenduar se ai e ka blerë pronën e kërkuar 50 vjet më parë, por dështoi të ofrojë dëshmi në mbështetje të pohimit. Megjithatë, duket se pala përgjegjëse ka ngritur një ndërtim në pronën e kërkuar.

21. Bazuar në dëshmitë para tij dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet. Komisioni vëren se në bazë të nenit 22.3 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Sekretaria Ekzekutive në bashkëpunim me Kryetarin e Komisionit ose Kryetarin e trupit gjykues të Gjykatës Supreme respektivisht, mund të shtyjë ekzekutimin e urdhrat të dëbimit për një afat kohor të arsyeshëm, kur çmon se rrethanat e garantojnë këtë. Sekretaria Ekzekutive mund të shqyrtojë ushtrimin e kësaj kompetence në këtë lëndë në lidhje me ndërtesën e ngritur nga pala përgjegjëse në pronën e kërkuar me qëllim që të lejohet zgjidhja miqësore e kontestit

b. *Kërkesa nr. 13661*

22. Kërkesa nr. 13661 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore dhe riposedimin e pronës së kërkuar. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletën poseduese të vitit 1994, që e identifikon paraqitësin e kërkesës si pronar të pronës së kërkuar. Fleta poseduese është verifikuar si e vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive.

23. Pala përgjegjëse kërkon të drejta ligjore për pronën e kërkuar, duke pohuar se ai është lejuar nga ndërmarrja shoqërore “Pasuria bujqësore” për të shfrytëzuar pronën e kërkuar. Në mbështetje të këtij pohimi, pala përgjegjëse ka paraqitur *inter alia* dy marrëveshje qiraje të 1999-2000, ku pretendohet se janë lidhur me ndërmarrjen shoqërore. Megjithatë, asnjë nga

këto marrëveshje nuk është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si e vërtetë. Asnjë dokument tjetër nuk është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës ose nuk është siguruar *ex officio* nga Sekretaria Ekzekutive të cilat do të mbështesnin pretendimet e palës përgjegjëse.

24. Bazuar në dëshmitë para tij dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet.

c. Kërkesa nr. 14298

25. Kërkesa nr. 14298 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon të drejtën e bashkëpronësisë dhe riposedimin e pronës së kërkuar. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur *inter alia* një vendim trashëgimie të vitit 1997, i cili tregon se paraqitësi i kërkesës e ka trashëguar pronën e kërkuar në bashkëpronësi dhe fletën poseduese të vitit 1998, që e tregon atë si bashkëpronar të pronës së kërkuar. Fleta poseduese dhe vendimi i trashëgimisë janë verifikuar si të vërteta nga Sekretaria Ekzekutive.

26. Pala përgjegjëse kërkon të drejta ligjore për pronën e kërkuar duke pretenduar se e ka blerë pronën e kërkuar. Megjithatë, pala përgjegjëse ka dështuar të paraqitë dëshmi në mbështetje të pohimit të saj.

27. Bazuar në dëshmitë para tij dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet.

d. Kërkesa nr. 14815

28. Kërkesa nr. 14815 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit për pronën e kërkuar e cila përfshin parcelën nr. 4387/27. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur *inter alia* vendimin e ndarjes të vitit 1997, lëshuar nga Komuna e Gjakovës, sipas të cilit, prona e kërkuar i është ndarë paraqitësit të kërkesës. Vendimi është verifikuar si i vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive. Sekretaria Ekzekutive ka siguruar *ex-officio* certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme që e tregon paraqitësin e kërkesës gjithashtu si mbajtës të së drejtës pronësore.

29. Pala përgjegjëse kërkon të drejta ligjore për pronën e kërkuar duke pohuar se prona e kërkuar i ishte ndarë atij në vitin 1989 nga Ndërmarrja Shoqërore "Ereniku" nga Gjakova. Në mbështetje të këtij pohimi, pala përgjegjëse ka paraqitur një vendim ndarje të vitit 1989 të lëshuar nga Ndërmarrja Shoqërore "Ereniku". Megjithatë Komisioni vëren se vendimi nuk lidhet me parcelën e kërkuar të tokës nr. 4387/27, por me parcelën e tokës 4387/2. Pala përgjegjëse pohon se parcela e kërkuar nr. 4387/2 është krijuar nga parcela nr. 4387/27 në rrjedhën e konsolidimit të tokës, por ai dështoi të ofrojë dëshmi në mbështetje të këtij pretendimi. Sekretaria Ekzekutive, po ashtu nuk mundi të sigurojë *ex officio* dëshmi që do të mbështesnin këtë pretendim.

30. Bazuar në dëshmitë para tij dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet.

31. Komisioni vëren se është ndërtuar një strukturë nga pala përgjegjëse në pronën e kërkuar. Në bazë të nenit 22.3 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Sekretaria Ekzekutive në bashkëpunim me Kryetarin e Komisionit ose Kryetarin e trupit gjykues të Gjykatës Supreme respektivisht, mund të shtyjë ekzekutimin e urdhrin të dëbimit për një afat kohor të arsyeshëm kur çmon se rrethanat e garantojnë këtë.

Sekretaria Ekzekutive mund të shqyrtojë ushtrimin e kësaj kompetence në këtë lëndë me qëllim që të lejohet zgjidhja miqësore e kontestit.

e. Kërkesat nr. 16521, 16522 dhe 16523

32. Kërkesat nr. 16521, 16522 dhe 16523 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore dhe riposedimin e pronave të kërkuara. Në mbështetje të kërkesave, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një numër dokumentesh përfshirë fletën poseduese që e tregon paraqitësin e kërkesës si pronar të pronave të kërkuara. Fleta poseduese është verifikuar si e vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive.

33. Pala përgjegjëse kërkon të drejta ligjore për pronën e kërkuar duke pohuar se prona e kërkuar i ka takuar familjes së paraqitësit të kërkesës, derisa ata u shpronësuan nga autoritetet pas Luftës së Parë Botërore. Megjithatë, pala përgjegjëse, ka dështuar të paraqitë dëshmi që do mbështetnin këtë pretendim. Më tej, Komisioni konsideron se nuk ka juridiksion për të shqyrtuar ligjshmërinë e akteve të shtetëzimit ose shpronësimit të tokës nga regjimet e mëparshme.

34. Bazuar në dëshmitë para tij dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet.

f. Kërkesat nr. 25086, 25087, 25088, 25089, 25090, 25091 dhe 90041

35. Kërkesat nr. 25086, 25087, 25088, 25089, 25090, 25091 dhe 90041 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës Cvetko Rajko Stankovic në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht në emër të nënës së ndjerë Cveta Stankovic.

36. Në mbështetje të kërkesave, paraqitësi i kërkesës, ka paraqitur fletën poseduese që e identifikon bashkëshortin e mbajtëses së të drejtës pronësore si pronar të pronave të kërkuara. Më tej, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur vendimin e trashëgimisë të vitit 1996 që tregon se mbajtësi i së drejtës pronësore ka trashëguar të drejtën pronësore të bashkëshortit të saj me anë të trashëgimisë. Fleta poseduese dhe vendimi i trashëgimisë janë verifikuar si të vërteta nga Sekretaria Ekzekutive.

37. Pala e parë përgjegjëse kërkon të drejta ligjore për pronat e kërkuara në kërkesat nr. 25086, 25087, 25088, 25089, 25090, 25091 dhe 90041 dhe pala e dytë përgjegjëse kërkon gjithashtu të drejta ligjore për pronat e kërkuara në kërkesat nr. 25088, 25090 dhe 90041. Palët përgjegjëse pohojnë se pala e parë përgjegjëse i ka blerë në vitin 2011 pronat e kërkuara në kërkesat nr. 25086, 25087, 25088, 25089, 25090, 25091 dhe 90041 nga paraqitësi i kërkesës Cvetko Rajko Stankovic përmes përfaqësuesit të autorizuar ligjor, Istref Tairi dhe më pas i ka shitur pronat e kërkuara në kërkesat nr. 25088, 25090 dhe 90041 tek vëllai i palës së dytë përgjegjëse. Në mbështetje të pretendimeve, palët përgjegjëse kanë paraqitur *inter alia* autorizimin përkatës që pretendohet të jetë lëshuar nga paraqitësi i kërkesës për përfaqësuesin e autorizuar, Istref Tairi si edhe një certifikate për të drejtat e pronës së paluajtshme që e tregon palën e parë përgjegjëse dhe vëllain e palës së dytë përgjegjëse si pronarë të pronave përkatëse të kërkuara, mbi bazën e transaksioneve të lartpërmendura. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të verifikojë si të vërtetë autorizimin e dhënë Istref Tairit nga paraqitësi i kërkesës. Paraqitësi i kërkesës e mohon se i ka shitur ndonjëherë pronat e kërkuara dhe deklaron se autorizimi që pretendohet se i është lëshuar Istref Tairit për të shitur pronat e kërkuara, është i falsifikuar. Në këto rrethana, Komisioni nuk mund të mbështetet në autorizimin e paraqitur nga pala e parë përgjegjëse dhe për rrjedhojë, Komisioni konsideron

se transaksioni mes palës së parë përgjegjëse dhe paraqitësit të kërkesës dhe transaksioni i mëpasëm me vëllain e palës së dytë përgjegjëse nuk mund të konsiderohen të vlefshme. Në këto rrethana, mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore nuk mund të konsiderohet se e ka humbur të drejtën pronësore të pronave të kërkuara për shkak të këtyre transaksioneve. Nga kjo rrjedh se Komisioni nuk mund të mbështetet në certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme pasi ajo bazohet në transaksione të pavlefshme.

38. Bazuar në dëshmitë para tij dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet në emër nënës së ndjerë të paraqitësit të kërkesës Cveta Stankovic, si mbajtëse e së drejtës pronësore.

g. Kërkesa nr. 34661

39. Kërkesa nr. 34661 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht nënës së tij, Jovanka Kosto Vukecevic-Perovic. Paraqitësi i kërkesës, kërkon konfirmimin e së drejtës së bashkëpronësisë dhe riposedimin e pronës së kërkuar. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës, ka paraqitur certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme të vitit 2007, që e tregon mbajtësin e së drejtës pronësore si bashkëpronar me Nikolla Vukicevic, xhaxhain/ dajën i paraqitësit të kërkesës dhe dy persona të tjerë. Certifikata është verifikuar si e vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive.

40. Pala përgjegjëse kërkon të drejta ligjore për pronën e kërkuar duke pohuar se ai ishte lejuar për të shfrytëzuar pronën e kërkuar që nga viti 1996 bazuar në dy marrëveshje qiraje. Në mbështetje të këtij pretendimi, pala përgjegjëse ka paraqitur dy marrëveshje qiraje që të dyja pretendohet se janë lidhur me bashkëpronarin e pronës së kërkuar, Nikola Vukicevic, e para më 25 prill 1996, për një afat qiraje prej tri vjet dhe e dyta më 4 shtator 1998, për një afat tjetër tre vjeçar. Megjithatë, asnjë në nga këto kontrata qiraje, prona e kërkuar nuk është lëndë e kontratave respektive të qirasë. Nuk është paraqitur asnjë dëshmi tjetër nga paraqitësi i kërkesës që mund të dëshmonte pretendimin e tij. Po ashtu Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të sigurojë *ex officio* dëshmi relevante. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se prona e kërkuar i ishte lëshuar vetëm me qira palës përgjegjëse nga Nicola Vukicevic në vitin 1996 ose 1997 për një vit dhe se më vonë Nicola Vukicevic është dëbuar nga prona e kërkuar dhe vdiq pak pasi u largua nga Kosova.

41. Bazuar në dëshmitë para tij dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet në emër të paraqitësit të kërkesës si mbajtës i së drejtës pronësore.

h. Kërkesat nr. 40674 dhe 40675

42. Kërkesat nr. 40674 dhe 40675 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij Blago Martinovic. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore dhe riposedimin e pronave të kërkuara. Prona e kërkuar në kërkesën nr. 40674 përfshin parcelën nr. 124 me një sipërfaqe prej 1 ha31 ari dhe 25 m2, ndërsa prona e kërkuar në kërkesën nr. 40675, përfshin parcelën nr. 239/1 me sipërfaqe prej 55 ari dhe 71 m2. Në mbështetje të kërkesave, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletën poseduese të vitit 1994, që e identifikon mbajtësin e së drejtës pronësore si pronar të vetëm të pronave të kërkuar. Fleta poseduese është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si e vërtetë.

43. Palët përgjegjëse në kërkesat nr. 40674 dhe 40675 kërkojnë të drejta ligjore për pronën e kërkuar. Pala përgjegjëse në kërkesën nr. 40674 pohon se babai i tij ka blerë 20 ari

nga parcela nr. 124 në vitin 1983, ndërsa pala përgjegjëse në kërkesën nr. 40675 pohon se babai i tij ka blerë 25 ari dhe 71 m² nga parcela e kërkuar nr. 239/1 më 1983. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, paraqitësi i kërkesës i konfirmoi të dy transaksionet me dy palët përgjegjëse dhe e informoi Sekretarinë Ekzekutive se ai kërkon të drejta ligjore për pjesët e mbetura, të pashitura të pronave përkatëse të kërkuara.

44. Në këto rrethana, Komisioni konstaton se kërkesa nr. 40674 duhet të miratohet me 1 ha 11 ari dhe 25 m² për parcelën nr. 124 dhe se kërkesa nr. 40675 duhet të miratohet me 30 ari për parcelën nr. 239/1. Në mungesë të ndarjes fizike të pronave të kërkuara repsektive, pas shitjes të disa pjesëve të tyre, duhet të miratohet urdhër për konfirmimin e së drejtës pronësore në dobi të mbajtësit të së drejtës pronësore pa urdhër dëbimi ose ndonjë formë tjetër të mjetit ndihmës ashtu si përcaktohet më sipër.

i. Kërkesat nr. 50626 dhe 50630

45. Kërkesat nr. 50626 dhe 50630 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të saj të ndjerë Srecko Jablan. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit për pronat e kërkuara. Në mbështetje të kërkesave, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletën poseduese të vitit 2003, që e identifikon mbajtësin e së drejtës pronësore, Srecko Jablan si mbajtës të së drejtës së shfrytëzimit të pronave të kërkuara. Fleta poseduese është verifikuar si e vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive.

46. Pala përgjegjëse kërkon të drejta pronësore për pronën e kërkuar duke pohuar se pronat e kërkuara i kanë takuar familjes së tij, por ishin konfiskuar nga autoritetet në vitin 1914 dhe më vonë në vitin 1941, pasi pronat i janë rikthyer familjes së palës përgjegjëse ato i janë shpronësuar përsëri familjes së palës përgjegjëse në mënyrë të paligjshme. Në mbështetje të pretendimit, pala përgjegjëse, ka paraqitur një vendim administrativ të vitit 1946. Vendimi tregon se autoritetet në atë kohe ia ndanë pronat Pero Jablan-it, paraardhësi i mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Më tej, në mbështetje të pretendimeve të tij, pala përgjegjëse ofroi deklarata dëshmitari, të cilat konfirmojnë thjesht se pronat e kërkuara i kanë takuar familjes së palës përgjegjëse para Luftës së Dytë Botërore.

47. Sipas mendimit të Komisionit, në mungesë dokumentacion dëshmues, deklaratat e dëshmitari nuk mund të konsiderohen dëshmi të mjaftueshme për të provuar të drejtën e përhershme të shfrytëzimit për pronën e kërkuar. Më tej, Komisioni konsideron se ai nuk ka juridiksion për shqyrtimin e akteve ligjore të shpronësimit nga regjimet e mëparshme. Rrjedhimisht, bazuar në dëshmitë para tij dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesat nr. 50626 dhe 50630 duhet të miratohen.

j. Kërkesa nr. 93028

48. Kërkesa nr. 93028 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore dhe riposedimin e pronës së kërkuar që përfshin parcelën nr. 477. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një numër dokumentesh përfshirë certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme të vitit 2013, që konfirmon të drejtën pronësore të paraqitësit të kërkesës për pronën e kërkuar. Certifikata është verifikuar si e vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive.

49. Pala përgjegjëse pohon se ai e ka blerë pronën e kërkuar në vitin 1986 mbi bazën e një kontrate joformale të blerjes të lidhur me familjen e paraqitësit të kërkesës. Kjo, megjithatë kontestohet nga paraqitësi i kërkesës, i cili deklaron se vetëm parcela fqinjë nr. 478, i është

shitur palës përgjegjëse dhe se kjo kontratë blerje është zyrtarizuar më pas me aktgjykim të gjykatës në vitin 2006. Më pas, kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, pala përgjegjëse pohoi se ai i kishte blerë të dyja parcelat nr. 477 dhe 478, por pranoi se ka dëshmi të dokumentuara që do të provonin vetëm blerjen e parcelës nr. 478. Pala përgjegjëse premtoi për të ofruar deklarata dëshmitari për të provuar blerjen e parcelës nr. 477, megjithatë dështoi ta bëjë këtë.

50. Bazuar në dëshmitë para tij, dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet.

51. Nga sa u tha më sipër, bazuar në dëshmitë që i posedon, Komisioni konstaton se në kërkesat e identifikuara në pjesët A B dhe C të listës së bashkangjitur:

- (a) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, ka të drejtën e pronësisë në lidhje me pronën e kërkuar, apo pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;
- (b) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, në secilin rast tani nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij apo të saj të pronësisë; dhe
- (c) kërkesa në secilin rast përfshin rrethanat e ndërlydhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

52. Rrjedhimisht, pasi paraqitësi i kërkesës në secilën nga kërkesat e identifikuara në pjesët A,B dhe C të listës së bashkangjitur, kanë provuar të drejtën pronësore pronën e kërkuar dhe në mungesë të një mbrojtje të vlefshme nga ana e palëve përgjegjëse, të gjitha këto kërkesa duhet të miratohen.

3. *Kërkesa për kompensim*

53. Komisioni vëren se në disa nga kërkesat e përfshira në këtë vendim, paraqitësit e kërkesave gjithashtu kërkojnë, përveç pronësisë, kompensimin për dëmin material apo humbje të shfrytëzimit, të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesat e tilla. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të hidhen poshtë.

B. *Vërejtje përmbledhëse*

54. Vendimi dhe urdhri i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

55. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo aplikohet në rastin konkret.

56. Vendimi i Komisionit nuk paragjykon të drejtën e paraqitësve të kërkesës ose mbajtësve të së drejtës pronësore sipas rastit, për të kërkuar konfirmimin e te drejtave të tyre pronësore për pronat e kërkuara para autoriteteve kompetente vendore të tilla si autoritetet kadastrale apo gjykatat vendore, në përputhje me ligjin në fuqi.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligj i Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftim i i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendim i përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendim i mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Gjykata Supreme mund të vjelë tarifat për procedurën e ankesës.

Informacione lidhur me procedurën e ankesave gjenden në fletën informuese për ankesën e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Version i në gjuhën angleze është version i zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron version i në gjuhën angleze**

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part A/Pjesa A/Deo A

KPA22016 REP						
KPA33486						

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part B/Pjesa B/Deo B

KPA16521 REP	KPA16522 REP	KPA16523 REP	KPA25086	KPA25087	KPA25088	KPA25089
KPA25090	KPA25091	KPA90041	KPA14298	KPA40674	KPA40675	KPA93028
KPA08816	KPA13661	KPA34661				

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part C/Pjesa C/Deo C

KPA50626						
KPA50630						
KPA14815						